



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.364/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Valbona Millaku Foniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e votueses Adriana Pajazit në Prishtinë, paraqitur kundër komisionerit të Qendrës së Votimit 1912E, Edis Hoti Prishtinë, për shkak të pengimit për votim për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet e pasafatshme ankesa e identifikuar me numër A.nr.364/2019 datë 09.10.2019, e parashtruar nga Adriana Pajazit- votuese në Prishtinë, paraqitur kundër komisionerit të Qendrës së Votimit 1912E, Edis Hoti Prishtinë.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 09.10.2019, ka pranuar një ankesë nga votuesja Adriana Pajaziti në Prishtinë, në të cilën kërkon ndërmarrjen e masave ligjore ndaj Edis Hoti, në cilësinë e komisionerit në Qendrën e Votimit 1912E, Salla “1 Tetori”, pasi që sipas paraqitësit të ankesës me datën 06.10.2019 rreth orës 13:00, në rastin e paraqitjes tek vija e votimit me shkronjën “P” (mbiemri: Pajazit), personi (komisioneri) me emrin Edis Hoti, ka refuzuar/penguar votimin me leje të kerrit (voztijes), pasi letërnjoftimit i ka kaluar afati me 30.09.2019, edhe pasi i kam kërkuar të me konsiderohet leja e kerrit, personi në fjalë prape me ka penguar, theksohet në ankesë.

Paneli pas vlerësimit paraprak të afatshmërisë së ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pasafatshme

Paneli pas shqyrtimit paraprak të ankesës, ka gjetur se nga përmbajtja e ankesës rezulton se të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara nga ankuesi ndërlidhen me procesin e votimit, dhe se e njëjta është paraqitur pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 119 paragrafi 1 i LZP-së ku përcaktohet se ” *Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqesë ankesë PZAP-it brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit*” si dhe neni 5 paragrafi 3 i

Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Rregullën Nr. 02/2015, ku përcaktohet: “Ankesat në lidhje me procesin zgjedhor për ditën e votimit parashtrihen pranë PZAP-it, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit”. Nga kjo rezulton se ankesa është paraqitur në PZAP, pasi që ka kaluar afati ligjor për të parashtruar ankesë, kjo nga fakti se ankesa është paraqitur me datë 09.10.2019, ndërsa shkelja e pretenduar supozohet se ka ndodhur me datë 06.10.2019 (dita e votimit) në ora 13:00, ndërsa pala ka pasur të drejtë që ankesën në fjale ta paraqes në PZAP, deri me datën 07.10.2019 në ora 13:00, andaj nga kjo shihet se ankuesja ka paraqitur ankesë në PZAP pas kalimit të afatit ligjor.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart në kuptim të nenit 118 dhe 119 të LZP-së, dhe nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A.nr. 364/2019 me datë 10.10.2019



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi lejohet e drejta në ankesë, ankesa dërgohet në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.